



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **44**

Prishtinë, më 28.4.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naim Maloku, Myrvete Pantina, Elheme Hetemi, Haset Cakolli, Ali Lajçi, Berat Luzha, Zef Morina, Dragiša Mirić,
Munguan : Selvie Halimi (pushim), Zulfi Merxha, Lulzim Zeneli (me arsyetim)

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Raporti i ZRRUM për vitin 2008,
3. Të ndryshme (disa çështje).

Kryesuesi Naim Maloku konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Raporti i ZRRUM për vitin 2008

Naim Maloku e paraqiti për diskutim raportin në fjalë, ndërkaq në emrin e tij personal konstatoi se kemi të bëjmë me një raport ndoshta më të mirën deri tani sa i përket bordeve që raportojnë Kuvendit, megjithatë ai propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e radhës kur do të ftohet përfaqësuesi i ZRRUM (Drejtori) sepse ai personalisht i ka disa pyetje për tabelat e paraqitura në raport, sidomos për rritjen e efikasitetit të efijencës së ujit (kapaciteti, kualiteti, humbja, arkëtimet etj), a ka mundësi për efikasitet më të madhe dhe pyetje të tjera që do ta kompletojnë raportin.

Elheme Hetemi u pajtua se është një raport shumë i mirë por sa është ajo e verifikueshme me realitetin në teren, këtë do të vërtetonte komisioni nëse viziton këtë organ të pavarur.

Naim Maloku u pajtua me konstatimin por shtoi se ky komision gjatë monitorimit të ligjit të mbeturinave do ti verifikoj të dhënat nga raporti, ndaj ftesa për mbledhjen e radhës do të shërben për të sqaruar të dhënat nga raporti.

Zef Morina, Hesel Cakolli, Myrvete Pantina u pajtuan me sugjerimet e kryesuesit por u pajtuan edhe me atë se kemi të bëjmë me një raport të mirë dhe të pasur, ndërsa në fund **Naim Maloku** në emër të komisionit propozoi këtë :

K O N K L U D I M

1. Raporti i Rregullatorit për ujëra e mbeturina konsiderohet si raport gjithëpërfshirës dhe i punuar mirë, për të cilin do të miratohet rekomandimi nga komisioni për seancën plenare në mbledhjen e radhës.

2. Në mbledhjen e dt. 5.5.2009 ftohet Drejtori i ZRRUM për një bashkëbisedim rreth raportit për vitin 2008.

Të ndryshme :

PROJEKTLIGJI PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Naim Maloku në cilësinë e kryesuesit të GP për këtë projektligj, tha se në ditët që i lamë pas është takuar me zyrtarët e MBPZHR me të cilët, pas vërejtjeve nga komisioni për buxhet, është arritur marrëveshja për të përmirësuar amendamentet e këtij komisioni rreth Agjencisë së Pagesave e cila tani e tutje do të emërtohet Njësia e pagesave për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural. Ky pajtim ka rezultuar pasi që në mes dy ministrive (MBPZHR dhe MEF) ka pasur pajtim paraprak rreth kësaj çështjeje.

Në vazhdim u shfaqën disa dilema rreth donacioneve nga **Zef Morina, Elheme Hetemi**, por kryesuesi tha se mjetet financiare do të kenë këtë njësi si adresë të veçantë direkt me një nënkod të veçantë. **Berat Luzha** konstatoi : nëse është pajtuar MEF, çdo gjë është në rregull. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Të përcjellën sërish Komisionit për Buxhet amendamentet e këtij komisioni nga dt. 3.3.2009 rreth projektligjit për bujqësi dhe zhvillim rural duke ndryshuar si vijon :

- Te amendamenti 3, përkufizimi për Agjencinë e pagesave të zëvendësohet me përkufizimin :

“Njësia e pagesave për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural” nënkupton njësinë organizative të Ministrisë për mbështetjen e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, e themeluar me këtë ligj.

Te amendamenti 7 ndryshohet si vijon :

Neni i ri

Pagesa e mjeteve

Pagesa e mjeteve për zbatimin e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural bëhet nga Njësia e pagesave për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural .

Neni i ri

Njësia e pagesave për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural

1. Njësia e pagesave për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural themelohet në kuadër të Ministrisë dhe ka kompetencat si në vijim :

1.1. zbatimin e masave të politikës bujqësore dhe të zhvillimit rural;

1.2. hartimin e raporteve dhe të analizave në përputhje me zhvillimin e bujqësisë;

1.3. ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të

- kontrollit;**
- 1.4. ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut;**
 - 1.5. krijimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të nevojshme;**
 - 1.6. zbatimin e masave të kontrollit dhe auditimit të brendshëm;**
 - 1.7. inspektimin e fermerëve dhe subjekteve që kanë përfituar nga fondet e programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.**
- 2. Njësia e pagesave për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural zbaton programe të mbështetjes ndërkombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural;**
 - 3. Organizimi, funksionimi dhe puna e njësisë, përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria.**

PLANI I VEPRIMIT I KOMISIONIT EVROPIAN

Naim Maloku tha se personalisht nuk e ka ditur që ky plan do të shqyrtohet në këtë mbledhje edhe pse koordinatori ka njoftuar në mënyrë elektronike, ndaj sugjeroi të shtyhet për javën tjetër, megjithatë ja dha fjalën **Blerim Velës** për të sqaruar planin në fjalë pasi që OSCE ka punuar me këtë plan. **Blerim Vela** tha se forma tabelore e kërkesave të komisionit evropian në fakt paraqet evidentimin nga ana e ekspertëve evropian të problemeve në fushat e caktuara ku mund të japin përgjigje organet e shënuara në këtë tabelë (në këtë rast ky komision), më tutje ky komision do të raportoi Kryesisë së Kuvendit çdo tre muaj për veprimet e ndërmarra p.sh. të ftoi ministrin përkatës dhe të njoftoi për këtë veprim të komisionit, etj.

Komisioni nxori :

K O N K L U D I M

Në mbledhjen e radhës komisioni do të shqyrtoj formën tabelore të kërkesave të komisionit Evropian.

PROJEKTLIGJI PËR PRODUKTET BIOCIDET

Naim Maloku konstatoi se ky projektligj dhe amendamentet e komisionit funksional janë shqyrtuar nga tri komisionet kryesore pa ndonjë vërejtje, ndaj konstatoi në emër të komisionit se e njëjta mund të procedohet në leximin e dytë.

RAPORTI I MMPH RRETH MONITORIMIT TË LIGJIT PËR MBETURINA

Naim Maloku tha se këtë raport do të mund ta shqyrtoj komisioni sot dy javë (më 12.5.2009) kur do të ftohen edhe zyrtarët nga MMPH – departamenti përkatës, me çka u pajtua komisioni.

ELHËME HETEMI

Propozoi që ky komision të njoftohet me Strategjinë për Zhvillimin e Bujqësisë nga MBPZHR para se ajo të miratohet nga Qeveria, mirëpo **Naim Maloku** ishte i dyshimtë se a mund ta bëjë këtë komisioni për një dokument ende pa e miratua Qeveria, ndaj kërkoi angazhimin e koordinatorit dhe mendimin e ish ministrit **Zef Morinës** i cili tha se nuk ka nevojë koordinatori të hulumtoj këtë çështje në rregullore të Kuvendit, ngase ministria përkatëse mund të ftoj komisionin në një takim më relaksues ku mund të epen kontributet për një dokument me rëndësi, ndaj kjo ishte edhe **konstatimi përfundimtar i komisionit** :

Ministria e Bujqësisë mund të propozoj apo të ftoj komisionin në një takim lidhur me këtë dokument (Strategjia e zhvillimit të bujqësisë) në formë të bashkëbisedimit dhe të bashkëpunimit.

-
Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,00, mbledhja e radhës do të mbahet më 5 maj 2009 në orën 13,00.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli